



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201802083/2

Tiranë ___/___/2019

Lënda: *Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastër.*

Drejtuar: **Zj. ZAMIRA RAMA**
Kryetare e Bashkisë

GJIROKASTËR

Zj. Luneda SUFALI
Drejtore e Përgjithshme
Shërbimi Social Shtetëror

TIRANË

Për dijeni: **Z. Aranit MUHO**
Drejtore i Shtëpisë së të Moshuarve

GJIROKASTËR

Të nderuara,

Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, më datë 18.10.2018, ka inspektuar Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastër.

Ky inspektim u krye në mbështetje të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: "Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe veëanërisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime

inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise”.

Qëllimi i inspektimit ishte zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2017 si dhe vijimi i inspektimit.

Ju bëjmë më dije se më datë 07.11.2017 është kryer inspektim në Shtëpinë e të Moshuarve në Gjirokastrë. Për problemet e konstatuara i rekomanduam Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë dhe Drejtoreshës së Përgjithëshme të Shërbimit Social Shtetëror marrjen e masave për:

- Shtimin në organikë me psikolog dhe mjek me kohë të plotë.
- Nga ana e Bashkisë Gjirokastrë të shihet mundësia e zëvendësimit të detyrës së “sanitaires” me “psikolog”.
- Bashkërendim të punës ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Gjirokastrë për vënien në funksionim të ngrohjes qendrore.
- Bashkërendim i punës përsa i përket planifikimit të Buxhetit dhe organikës së këtij institucioni.
- Ngritjen e një grupi pune për të grumbulluar të gjithë personat me probleme psikike në një qendër zhvillimi.

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, Bashkia Gjirokastrë na informon:

- *Për rekomandimin nr.1*, mundësitë e Bashkisë janë të kufizuara, pasi për plotësimin e tyre kërkohen planifikime në buxhetin vjetor, të cilat për vitin 2018 janë miratuar me Vendimet e Këshillit Bashkiak.
- *Për rekomandimin nr.2*, Bashkia do të bëjë përpjekjet e nevojshme në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me Drejtorinë e Shërbimit Social shtetëror për të miratuar dhe realizuar një investim për realizimin e kësaj detyre.
- *Për rekomandimin nr.3*, edhe pse komisionimi është kompetencë e Komisionit të Pranimit të Shërbimit Social Shtetëror, do të rrisin kontaktet e vazhdueshme me këtë institucion për përqëndrimin e këtyre personave, pasi për atë Bashki ka qenë problem shqetësues i vazhdueshëm.
- *Për rekomandimin nr.4*, nga mjetet e Bashkisë, është vënë në dispozicion një mjet për realizimin e nevojave të të moshuarve.

Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e tre rekomandimeve të para, ia adreson Bashkisë Gjirokastrë, duke qenë se Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë është në varësinë e asaj Bashkie.

Për rekomandimin 4, sipas asaj drejtorie, në qendrat e zhvillimit pranohen persona me aftësi të kufizuara deri në moshën 21 vjeç. Përsa i përket të moshuarve me probleme të shëndetit në Institucionet për të Moshuar, trajtohen nga ana e mjekut dhe ekipit multidisiplinar të institucionit me terapi të veçanta mjekësore dhe sociale.

Nga takimi i bërë me Drejtuesin e Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokatër, me punonjësen sociale dhe shefen e financës, konstatuam se rekomandimi

1. *Për shtimin në organikë me psikolog, mjek me kohë të plotë, nuk ishte realizuar.*
2. *Për bashkërendim të punës ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Gjirokatër për vënien në funksionim të ngrohjes qendrore, nga ana e Bashkisë Gjirokatër projekti do i përcillet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fund të vitit 2018, me qëllim që të fillojë funksionimi në fillim të vitit 2019.*
3. *Për ngritjen e një grupi pune për të grumbulluar të gjithë personat me probleme psiqike në një qendër zhvillimi, nuk është realizuar.*
4. *Për bashkërendim e punës përsa i përket planifikimit të buxhetit dhe organikës së këtij institucioni, Bashkia Gjirokatër ka realizur vendosjen e një makinë (benz) për nevojat e institucionit.*

Nga inspektimi i kryer rezultoi si më poshtë:

Në këtë qendër strehhen të moshuar duke filluar që nga mosha 60 vjeç, por ka edhe përfitues të tjerë, të cilët vijnë si raste emergjente. Aktualisht strehoheshin 56 të moshuar ndërkohë që edhe kapaciteti i kësaj qendre është për 56 persona. 12 të moshuar janë të sëmurë me probleme të rënda shëndetësore, prapambetje mendore, të sëmurë paraplegjikë e tetraplegjikë.

Personeli i kësaj qendre përbëhet nga 21 punonjës, ku të gjithë ishin të kualifikuar sipas pozicionit përkatës. Vlerësimi i punës bëhet një herë në vit

Dosjet personale të punonjësve të kësaj qendre mbahen në institucion. Përshkrimi i punës për personelin pasqyrohet në Rregulloren e Brendshme e Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokatër, e miratuar nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Gjirokatër.

Drejtuesi i këtij institucioni u shpreh se çdo vit bëhet trajnimi i stafit. Është kryer trajnim nga Shërbimi Social Shtetëror për financieren, punonjësen sociale dhe kryeinfermieren, trajnim nga Drejtoria e Formimit Profesional Publik, Gjirokatër. Pas trajnimit, punonjësit janë pajisur me çertifikata.

Me problemet psiko-sociale merret vetëm një punonjëse sociale.

Shërbimet mjekësore realizohen nga mjeku, i cili punon me kohë të pjesshme. Spitali Rajonal i Gjirokatrës herë pas here dërgon mjekë për të parë gjendjen shëndetësore të të moshuarve, sipas një akt-marrëveshje.

Shërbimi dentar realizohet me shpenzimet e të moshuarve, por edhe nga institucioni.

Ka një plan individual për çdo të moshuar dhe secili ka kartelën e tij mjekësore. Medikamentet që marrin të moshuarit pasqyrohen në një bllok të veçantë, i cili sekretohet dhe ruhet në arshivë.

Janë 35 të sëmurë kronikë. Barnat e rimbursueshme janë të pasqyruara në kartelë, ndërsa ato të parimbursueshme i mbulon vetë institucioni sipas rekomandimit të mjekut.

Kuota ushqimore ishte rritur në vlerën e 360 lekëve në ditë për çdo person që trajtohet në qendër, e mjaftueshme për përfituesit.

Menyja javore përcaktohet nga të moshuar, kujdestarët, punonjësja sociale dhe kuzhinierja, sipas mendimit të të moshuarve.

Në ambjentet e brendëshme dhe të jashtme të këtij institucioni mbizotëron pastërtia, gjë që tregon për një bashkërendimin të punës së Drejtuesit, stafit dhe përfituesve.

Ishte kryer rikonstruksioni i lavanderisë, me veshje pallkash dhe dhomë tharëse.

Të moshuarit për higjienën e tyre personale, bënin dush dy herë në javë.

Në çdo kat, në ambjente të veçanta ishin të afishuara rregullorja e brendshme, standardet që duhet të respektonin punonjësit e qendres dhe të përfituesve.

Kutia e ankesave, çelësi i së cilës mbahet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror në Gjirokastrë, hapet në datë 1 (një) të çdo muaji, në prani të Drejtorit të institucionit dhe punonjësit social.

Furnizimi me artikuj hotelerikë gjatë vitit 2018 ka qenë shumë i kënaqshëm.

Mjetet për shmangjen e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në një kënd të caktuar dhe ishte bërë kolaudimi i tyre. Stafi është i trajnuar për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit. Ishin vendosur shkallët e emergjencës.

Organizohen aktivitete të ndryshme, festa fetare dhe zyrtare, ditëlindje, takime me shkolla të ndryshme të qytetit, takime me të moshuar, aktivitete me rastin e ditës së të Moshuarve etj.

Monitorimi i standarteve për përfituesit kryhet nga Drejtoria Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoria e Higjienës, Drejtoria e Ushqimit Gjirokastrë.

Të moshuarit vizitohen shpesh nga të afërmit e tyre. Në dispozicion të tyre është një dhomë dhe takimi pasqyrohet në një regjistër.

Nga intervistimi që patëm me të moshuarit, ata ishin shumë të kënaqur nga shërbimi i gjithë stafit të këtij institucioni. Shumica e të moshuarve kanë vite që jetojnë në këtë institucion dhe ndihen si në shtëpinë e tyre.

Gjatë këtij inspektimi, u konstatuan edhe problematikat e mëposhtme:

- Janë 12 të moshuar me probleme të rënda shëndetësore, prapambejtje mendore, gjë që krijon shumë shqetësim tek të moshuarit e tjerë.
- Në organikën e punonjësve të institucionit nuk ka psikolog, i domosdoshëm të jetë i pranishëm për këto kategori përfituesish.
- Pavarësisht se ka një projekt, ku siç u shprehëm më lart, do i përcillej Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fund të vitit 2018, rreziku për jetën e të moshuarve që mund të vijë nga ngrohja me rezistenca është evident. Kjo, pasi mund të ndodhin avari në sistemin elektrik apo mund të mos fiken në mbrëmje.
- Një problem që vijon të mbetet shqetësues është edhe ai i mjekut me kohë të pjesshme, pasi të moshuarit janë me probleme shëndetësore të ndryshme dhe kanë nevojë që mjeku të jetë çdo ditë i pranishëm në qendër, të paktën 8 orë.
- Ka shumë kërkesa për sistemimin në këtë institucion, por kapaciteti është i pamjaftueshëm.

Sa më sipër, për të plotësuar standartet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit në institucionet rezidenciale, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave për

1. Shtimin në organikë me psikolog dhe mjek me kohë të plotë.
2. Bashkërendim të punës ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Gjirokastrë për vënien në funksionim të ngrohjes qendrore.
3. Ngritjen një qendre socio-sanitare, ku të trajtohen me përkujdesje të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.
4. Shtimin në buxhet për shtesë të një kati, me qëllim sisteminim në këtë institucion të të moshuarve të tjerë.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, ku thuhet se, *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin rekomandimeve, siupas kompetencave tuaja ligjore.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R

Ermir KAPEDANI